



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 42/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor, Kudret Hasani duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së flamujve partiak në objekte publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

VENDIM

LEJOHET tërheqja e ankesës e Koalicionit PDK-AAK-NISMA,, Anr. 42/2017 të datës 03.06.2017.

Arsyetim

Koalicioni PDK-AAK-NISMA ka paraqitur ankesë në PZAP kundër koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së flamujve partiak afër objektit të Komunës së Podujevës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Me datë 04.06.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesë me numër:Anr.42/2017 të datës 03.06.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, PZAP -i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.42/2017 më datën 06.06.2017.

